

RELACION ARGUMENTUES

Lidhur me propozimin e pikës së parë:

Masat shtrënguese të miratuara për të parandaluar përhapjen e virusit covid-19 janë ndër të sidomos në sektorin e turizmit, të transportit dhe biznesit të vogël. Për më tepër që sektori i turizmit sapo rimëkëmbej nga pasojat e shkaktuara nga tërmeti i 26 Nëntorit, i cili i dha një goditje të rëndë, sidomos hotelierisë në bregdet.

Gjithashtu paralizimi i transportit si pasojë e masave shtrënguese ka shkaktuar dhe po vazhdon të shkaktojë humbje të mëdha financiare për të gjithë operatorët.

Mbyllja e aktivitetit ekonomik ka vendosur në sprovë dhe biznesin e vogël dhe të mesëm duke qenë dhe më i ndjeshëm ndaj këtyre situatave.

Duke parë specifikën e veçantë që kanë këto sektorë, kanë nevojë për një vëmendje të madhe nga ana e qeverisë Shqiptare.

Lidhur me propozimin e pikës së dytë:

Të gjithë sektorët e ekonomisë janë të lidhura ngushtë me njeri tjetrin. Ne kërkojmë që deri në rikthimin e normalitet në vend, të kombinohen lehtësira fiskale, shtyrje dhe në raste të veçanta anulimin e disa detyrimeve të bizneseve, riskedulimin e tatim fitimit, tvsh, sigurimet shoqërore, tatimi mbi të ardhurat dhe tatimi në burim, për të gjitha kompanitë që të ardhurat e muajt mars 2020 janë **20% më pak** se mesatarja e muajt shkurt dhe janar 2020. Për t'ju ardhur në ndihmë sipërmarrjes, kërkojmë nga shteti marrjen në konsideratë të këtyre kërkesave jetike për vazhdimin e bizneseve, pasi rënia e prodhimit dhe bllokimi i aktivitetit të tyre shumë shpejt do të përkthehet në një rënie të të ardhurave buxhetore dhe rritje të deficitit publik.

Për të siguruar vijueshmërinë, edhe pse me staf të reduktuar, bizneset kërkojnë nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), furnizimin pa ndërpreje si dhe reduktimin e çmimit në **20% ulje** për furnizimin me energji elektrike dhe një reduktim në çmimin për furnizimin me ujë për të gjitha kompanitë në sektorin e prodhimit.

Precedenca të ngjashme kanë ndodhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, për të krijuar sado pak lehtësi në përballimin e kësaj situate është e domosdoshme subvencionimi i 50% të qirasë për të gjitha ato sipërmarrje që kanë pezulluar aktivitetin e tyre tregtare në respektim të masave shtrënguese.

Zgjatja në kohë e këtyre masave duke bllokuar aktivitetin e tyre natyrshëm do të sjelli humbje të mëdha financiare, ndaj lind si domosdoshmëri mbështetja nga ana e qeverisë shqiptare.

Lidhur me propozimin e pikës së tretë:

Vështirësitë me të cilat po përballet biznesi do të reflektohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe tek punëmarrësit e saj.

Pamundësia për të përmbushur obligimet e biznesit si rezultat i masave shtrënguese kërkon mbështetjen e menjëhershme të qeverisë.

Aktualisht qeveria shqiptare ka parashikuar në paketën ekonomike ndihmëse vetëm për bizneset me qarkullim deri në 14 milion lekë, duke premtuar pagë për të vetëpunësuarit dhe familjarin e vetëdeklaruar të vetëpunësuarit.

Për sa më sipër, është e domosdoshme krijimi i lehtësirave për të gjithë sipërmarrjet që të ardhurat e muajit mars 2020 janë 30% më pak se mesatarja e muajit janar dhe shkurt 2020, duke i përjashtuar nga të gjitha detyrimet fiskale (tatim fitimi, tvsh, sigurimet shoqërore, tatimit mbi të ardhurat dhe tatimi në burim), taksat vendore si dhe kompesimi nga qeveria shqiptare e të gjithë punonjësvë të këtyre kompanive, në rast se kompanitë nuk kanë bërë shkurtime më shumë se 10% të fuqisë punëtore.

Kërkesa e propozuar synon sigurimin e likuiditetit të nevojshëm si dhe mosçënimin e vendeve të punës për punonjësit e sipërmarrjes që përballen çdo ditë me sfidat e gjendjes së jashtëzakonshme.

Lidhur me propozimin e pikës së katërt:

Referuar situatës ekonomike të krijuar nga masat shtrënguese, pamundësisë financiare të bizneseve për të shlyer detyrimet fiskale (tatime/taksa dhe detyrimin për konsumin e ujit dhe energjisë), për të likuiduar në vazhdimësi pagat e punonjësve propozojmë marrjen e masave për hapjen sa më shpejt të aplikimeve për përfitimin e kredisë përmes garancisë sovrane.

Garancia sovrane e vënë në dispozicion të sipërmarrjes private, nëpërmjet Paketës Ekonomike të miratuar nga qeveria shqiptare, duhet të jetë e pa limituar dhe të përmbushë të gjitha kërkesat e sipërmarrjes private që kanë një rënie të të ardhurave në muajn mars 2020 më shumë se 10 % e mesatares e muajt janar dhe shkurt 2020, përfshirë edhe sipërmarrjet bujqësore, blegtorale dhe të peshkimit.

Këto sipërmarrje duhet të aplikojnë për kredi, vetëm për likuidimin e pagave të punonjësve, likuidim të furnitorëve dhe kapital qarkullues.

Gjithashtu, duke pasur parasysh dhe faktin që në Paketën Emergjente Fiskale të miratuar nga qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, ndër pikat kryesore si mbështetje për biznesit ishte edhe sigurimi i kredisë me 0% interes për sipërmarrjet që kanë vështirësi financiare për shkak të emergjencës së shëndetit publik, propozojmë që garancia sovrane të ofrohet me një tarifë interesi jo më shumë se 0.2%.

Duke qenë se ende nuk ka një parashikim se sa do të jetë kohëzgjatja e masave shtrënguese propozojmë që shlyerja e kësaj kredie të fillohet në janar të vitit 2021 ose në një afat që gjykohet i arsyeshëm, gjithmonë nëse do të jemi në fazën e kthimit në normalitet.

Kësti i shlyerjes mujore nuk duhet të jetë më shumë së 20% e fitimit mujor të realizuar nga kompania kredimarrëse.

Lidhur me propozimin e pikës së pestë:

Një ndër përparësitë e qeverisë shqiptare duhet të jetë dhe rishikimi i përsheptuar i buxhetit, duke përjashtuar të gjitha investimet dhe shërbimet publike të cilat konsiderohen jo bazike në përputhje dhe me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Rishikimi i buxhetit duhet të reflektojë situatën aktuale në të cilën ndodhet vendi, duke pezulluar ose shtyrë në kohë pagesat e kontratave konçensionare dhe anulimin e projekteve të tilla për të cilat ende nuk kanë filluar punimet, me qëllim pasjen e fondeve të domosdoshme për të lehtësuar rifillimin e aktivitetit ekonomik në vend.

Lidhur me propozimin e pikës së gjashtë

Ndër të tjera, dhomat e tregtisë dhe shoqatat e sipërmarrjes private, kërkojnë nga qeveria shqiptare, specifikisht nga institucionet e pushtetit qendror dhe institucionet e pushtetit lokal, marrjen e masave për likuidimin e të gjitha detyrimeve ndaj sipërmarrjes private, brenda muajit prill 2020.

Shlyerjen në kohë të të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e veprave dhe shërbimeve publike që nuk janë të anuluar me apo pa rishikim buxheti.

Referuar dhe modeleve të ndërhyrjes me paketa financiare në ekonomi nga qeveri të ndryshme dhe qasjes së tyre në përballimin e situatës së krijuar nga pandemia covid-19 është e rëndësishme që krahas implementimit sa më të shpejt të paketës ekonomike, qeveria shqiptare duhet të angazhohet në shlyerjen e të gjithë detyrimeve që ka ndaj sipërmarrjes private, për të siguruar likuiditet të mjaftueshëm në lehtësimin e pasojave të ardhura nga masat shtrënguese.

Lidhur me propozimin e pikës së shtatë

Ndodhur në kushtet e ndërprerjes së veprimtarisë normale të aktivitetit tregtar të sipërmarrjes private dhe pamundësisë financiare për të shlyer detyrimet fiskale është domosdoshmëri pranimi i kërkesës së sipërmarrjes si kredimarrës për riskedulimin e kredisë dhe shtyrjen e aftatit për të paktën 3 muaj dhe në varësi të vijshmërisë së masave shtrënguese.

Si pasojë e kësaj situatë, duke pasur një rënie të ndjeshme të arkëtimeve, të gjitha bizneset hasin vështirësi në likuidimin e detyrimeve ndaj bankave.

Ndaj kërkojmë pranimin e kërkesës për shtyrje të kredive të çdo subjekti dhe shmangien e pengesave proceduriale dhe burokratike në dhënien e këtij shërbimi bizneseve të prekura nga masat shtrënguese.

Lidhur me propozimin e pikës tetë:

Kjo situatë e paprecedentë ka prekur të gjitha sipërmarrjet private duke krijuar mjaftë vështirësi në aktivitetin e tyre tregtar.

Ndaj, për të gjithë ato sipërmarrje shqiptare që do të ndërmarrin nisma për të kryer donacione për t'i ardhur në ndihmë përballimit të situatës së vështirë që ka krijuar përhapja e virusit Covid 19, kërkojmë njohjen e tyre si shpenzim i zbritshëm nga sistemi fiskal.

Në këtë mënyrë, përtej lehtësirave që i jepet biznesit, vlerësohet dhe kontributi i tyre ku pavarisht vështirësive që vetë këto sipërmarrje po kalojnë si rezultat i masave shtrenguese janë të gatshëm të kontribuojnë duke ndihmuar në përballimin e kësaj pandemie globale.